



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	29.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHUK	7748/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1426/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi - Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1426/2023, të datës 20.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Hanit të Elezit, në çështjen juridike „Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim më datë 29.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1426/2023 e datës 20.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Komunën e Hanit të Elezit sipas Akt Emërimit me numër 02.Nr.567/2011 të datës 30.12.2011 në pozitën e punës „Zyrtar i Gjendjes Civile” në kuadër të Sektorit të Ofiqarisë në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, me koeficient shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave, ankuesi disa herë ka parashtruar emal tek udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, përmes së cilave ka kërkuar që të caktohet në pozitën e punës Shef i Gjendjes Civile në Komunën e Hanit të Elezit.

Ankuesi i pakënaqur me heshtjen administrative nga ana e organit të punësimit, respektivisht Komunës së Hanit të Elezit, më datë 20.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7040/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që të rregullohet pozita e tij e punës, pasi që ankuesi është i vetmi zyrtar që e kryen detyrën e Shefit të Gjendjes Civile ndërsa trajtohet si zyrtar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Hanit të Elezit. Ndërsa Këshilli më datë 06.12.2023 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 7040/2023 të datës 20.11.2023 të parashtruar nga ankuesi B.M në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 15.11.2023 ndaj Komunës se Hani i Elezit ;E-malin e datës 17.08.2023 nga E.A ; Akt emërimin e datës 30.12.2011 me Nr.567/2011; Kontratës e marrëdhënies se punës me numër 03/18 ; Kontratës e marrëdhënies se punës te datës 27.12.2023 me Nr. 02-112/57 ;Kontratën e Marrëdhënies se punës te datës 02.01.2007 me Nr. 20/07; Kuvendi PNJK-ës ne Nr.011/07 te datës 01.01.2007 ; Akt vendimin e datës 27.12.2006 me Nr.478/06 ;certifikate e datës 27.12.2023 ,e Nr.478/06 ; Vendimin e datës 08.02.2016 me Nr.1410/2016 ; Përgjigjen ne kërkesën me Nr.02-nr.2023 ;Certifikatën për pjesëmarrje ne trajnim ;Trajnimin për Zyrtare te Gjendjes Civile ;Certifikatën për trajnimin për kod te etikes ; Certifikatë e OSCE ; Certifikatën për pjesëmarrje ne trajnim ; Lista e distribuimit e datës 02.07.2018; E-malin e datës 01.12.2023 nga I.M ;Përgjigjen ne ankese me A.Nr.1426/2023; Akt emërimin e datës 30.12.2011 me Nr.567/2011;Pershkrimin e vendit te punës; Kontratën e marrëdhënies se punës me numër 03/18 ; Vendimin e datës 12.10.2023 me Nr. 23/165; Kontratë e marrëdhënies se punës te datës 27.12.2023 me Nr. 02-112/57 ; Vendimin e datës 01.01.2007 me Nr019/07 ; Akt vendimin e datës 27.12.2006 me Nr.478/06 ; Certifikatën e datës 27.12.2006 me Nr.478/06 E-malin e datës 29.06.2022 ; E-malin e datës 11.08.2023 nga A.J ;E-malin e datës 17.08.2023 nga E.A;E-malin e datës 01.08.2023 nga N.K ; E-malin e datës 18.10.2023; Deklaratën e datës 09.11.2023 me Nr.03/9605; ; Liste distribuomi ;Akt vendimin datës 02.05.2023 me Nr.3625/2023;; Vendimin e datës 08.02.20216 me Nr.1410/2016 ;Formularin për ankese ; Pasqyrën e pagesës mujore ; Raportin punës se komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërorë te informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike; Vendimi i Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve te datës 22.02.2022 me Nr. 01/38 ; Vendimin e datës 07.06.2023 me numër 01/233; Listë Distribuimi datës 16.03.2023 .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se duhet të bëhet rregullimi i pozitës së tij të punës komform detyrave dhe përgjegjësiive të punës që i kryen, përkatësisht kërkon nga Komuna e Hanit të Elezit që të caktohet në pozitën e punës Shef i Gjendjes Civile pasi qe të gjitha kërkesat e drejtuara nga MPB-ARC si dhe Drejtoret e Administratës Komunale me drejtohen në cilësinë e shefit të gjendjes Civile.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur i cili kërkon tw caktohet në pozitën e punës „Shef i Sektorit të Gjendjes Civile” në Komunën e Hanit të Elezit, dhe ka konstatuar se në bazë të dëshmimeve të ofruara nga ankuesi dhe

organi i punësimit, ankuesi është i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit sipas Akt Emërimit me numër 02.Nr.567/2011 të datës 30.12.2011 dhe mbanë pozitën e punës „ Zyrtar i Gjendjes Civile” në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, me koeficient shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi i ankuesit për kalim në pozitën „Shef i Sektorit të Gjendjes Civile” nuk mund të realizohet me vendim të njëanshëm ngase sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në kohë gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht me nenin 38 paragrafi 1, është përcaktuar se: *“Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë”,* kështu që duke marr parasysh që pozita „Shef i Sektorit të Gjendjes Civile” të cilën kërkon ankuesi të sistemohet është pozitë e kategorisë së ulët drejtuese dhe në këtë rast për të kaluar nga një pozitë e kategorisë profesionale në atë të ulët drejtueses aplikohen dispozitat e nenit 39 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *“1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji”.*

Marrë për bazë dispozitat e cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se pretendimi i ankuesit për sistemim në pozitën „Shef i Sektorit të Gjendjes Civile”, nuk ka mundur të realizohet pa kaluar hapat ligjor të përmendur si më lartë, ndërsa tashmë që është i aplikueshëm Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 39 paragrafi 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj”,* mbi këtë bazë nuk ka norma ligjore e cila përcakton se kalimi nga një pozitë në një pozitë tjetër të kategorisë tjetër mund të bëhet pa procedura, andaj pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në mandatin e tij Kushtetues dhe Ligjor, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi kritere të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj institucionet lidhur me ngritjes në detyrë duhet të respektojnë dispozitat ligjore, rregullat dhe parimet sipas legjislacionit në fuqi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1426 /2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit
- Arkivit të KPMSHCK-së

